



REPUBLIKA E KOSOVËS - ZYRA E PRESIDENTES
REPUBLIC OF KOSOVO - OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - KANCELARIJA PREDSEDNICE

Prishtinë, datë, 15.10.2025

THIRRJE PËR OFERTIM - DEPO ME QIRA

Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës, është në kërkim të një objekti me qira për ta përdorur si depo me **qëllim të vendosjes dhe ruajtjes së inventarit dhe pasurisë së Presidencës.**

Subjektet e interesuara mund ti paraqesin ofertat e tyre, objektet e të cilave i plotësojnë kushtet administrative dhe teknike të paraqitura si më poshtë:

Kushtet administrative:

- Të mos ketë çështje të pa rregulluara pronësore, çështje në kontest apo që objekti të jetë i vendosur nën hipotekë.
- Pronari i objektit të ketë lejen e ndërtimit dhe të gjitha dokumentet tjera të kërkuara sipas ligjeve në fuqi;

Kushtet e detyrueshme teknike që duhet të plotësoj objekti:

- Objekti të jetë me lokacion në jo më larg se 1 km nga Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës;
 - Objekti të ketë së paku sipërfaqe 200-250 m²;
 - Ti ketë 1 zyrë 20 – 30 m² (e nevojshme për administrimin e dokumentacionit dhe menaxhimin e materialeve);
 - Objekti duhet të ketë së paku 1 tualete funksional;
 - Të jetë në gjendje të rregullt pa pasur nevojë për ndërhyrje të tjera për renovim;
 - Rryma, uji, interneti dhe shërbimet tjera të jenë të instaluar në objekt/ zyre;
 - Parkingu së paku për 2 vetura;
-

- Dera kryesore e objektit të jetë e siguruar;
- Të ketë sipërfaqe te mjaftueshme dhe kushte të përshtatshme për ruajtjen e materialeve logjistike,
- Të ketë hyrje të përshtatshme për qarkullimin e automjeteve (ngarkim shkarkim),

Kushtet e preferueshme teknike:

- Objekti të ketë qasje të lehtë për veture dhe kombi bus;
- Të ketë ndriçim të duhur përgjatë gjithë perimetrit të jashtëm të objektit;
- Të ketë të instaluar kamera në gjithë hapësirat e objektit;
- Të ketë të instaluar sistemin e alarmit kundër vjedhjes.

Kushtet e kontratës:

ZPRK, planifikon lidhjen e kontratës për qiranë e objektit për një periudhë të caktuar deri në dy vite, me mundësi vazhdimi me njoftim paraprak 3 muaj më herët si Autoritet kontraktues.

Paraqitja e ofertave:

Të gjithë të interesuarit duhet të dorëzojnë:

1. Dokumentin identifikues të pronarit;
2. Certifikatën e pronës (jo më të vjetër se 30 ditë);
3. Kopjen e lejes së ndërtimit;
4. Skicë të përgjithshme të objektit;
5. Çmimin i ofruar për metër katrorë si dhe çmimi total për qiranë mujore të objektit.

Subjektet e kontaktuara për negociim të kushteve të kontratës duhet të prezantojnë kopjen e projektit teknik të objektit, në formë të shtypur apo elektronike.

Subjekti i përzgjedhur për nënshkrimin e kontratës, paraprakisht duhet të paraqesë:

1. Dëshmitë për kryerjen e obligimeve tatimore lidhur me atë objekt;
2. Dëshmitë për kryerjen e obligimeve ndaj ndërmarrjeve publike deri në ditën e planifikuar për lidhjen e kontratës.

Ofertat e kompletuara, të mbyllura me kuvertë, duhet të dorëzohen në Arkivin e ZPRK-së në katin III Nr.319 të Ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës”.

Ofertat mund të dorëzohen brenda 10 ditëve, prej ditës së shpalljes po ashtu nuk duhet të kalojë çmimin mujor vlerën prej 1,000.00 €.

ZPRK, mban të drejtën e vizitës paraprake në objekte dhe për negociimin e kushteve specifike.

Çdo formë tjetër e komunikimit , përveç udhëzimeve të mësipërme nuk do të merret parasysh.